



Planuar / Dërguar Punësimi / Profili Recruited / Delivery	30.03.2022	2	viti year
Organ / Shërbimi Organ / Service Org / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shërbimi / Service Service	Sasia Quantity Quantity
SKPM SHCK	1738/2022		111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 40 /2022

Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit.
2. Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Ministres së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dostizimi Prishta / Pristina Received / Delivered	30-03-2022	2	viti god Year
Organ / Shista Organ / Shista Org / Unit	nr. Prot nr. Prot Prot. No	Shitup / a Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	1738/2022		.1/16

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

AUTORITETIN KOMBËTAR TË KUALIFIKIMIT

PËR VITIN

2020

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	5
FUSHA E MONITORIMIT.....	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË AUTORITETIN KOMBËTAR TË KUALIFIKIMIT.....	7-16

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tutje referuar si Këshilli) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;
- monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;
- Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;
- Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këtë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efektive, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

**RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË AUTORITETIN KOMBËTAR TË
KUALIFIKIMIT PËR VITIN 2020**

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kombëtar të Kualifikimit përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit me datë 25.03.2020, në prezencë të Zyrtares së Personelit, si mostra për shqyrtim ka marrë një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren e vitit 2013 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit;
- Lista me emrat e nëpunësve të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta së bashku me marrëveshjet si në vijim: Marrëveshja për shërbime të veçanta me numër 02/261 e datës 28.08.2020, Marrëveshja për shërbime të veçanta me numër 02/185 e datës 16.06.2020, Marrëveshja për shërbime të veçanta me numër 02/387 e datës 16.10.2020, Marrëveshja për shërbime të veçanta me numër 02/408 e datës 30.10.2020, Lista me pozitat e nëpunësve sipas akt emërimeve;
- Organogrami i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve;
- Lista me marrëveshjet për shërbimet e veçanta për vitin 2019;
- Dosja e kandidatës për pozitën "Asistente administrative" me të gjitha dokumentet e bashkangjitura;
- Formularët e shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit;
- Kërkesat e datës 27.01.2021, 01.02.2021, 01.03.2021 dhe 08.03.2021 për dhënie të opinionit ligjor nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve së bashku me përgjigjen e datës;
- Vendim me numër 02/30 i datës 05.02.2021 mbi lejimin e pushimit të lehonisë; Vendim me numër 02/164 i datës 15.10.2020 për plotësim ndryshim të lejimit të pushimit të lehonisë, Vendim me numër 02/164 i datës 02.06.2020 mbi lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendim me numër Nr.Prot.1910 i datës 21.08.2020 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve;
- Vendim me numër 02-936 i datës 07.08.2019 mbi lejimin e pushimit pa pagesë së bashku me kërkesën e nëpunëses dhe dëshmitë mbi sëmundjen e anëtarit të familjes;
- Vendim me numër 02/444 i datës 13.08.2018 për pezullim të dakorduar nga puna të nëpunësit Avni Gashi;
- Vendim me numër Nr.17/64 i datës 11.09.2018 mbi emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve;
- Vendim me numër 02/566 i datës 08.12.2016 mbi lejimin e pushimit të lehonisë së bashku me dëshminë mjekësore;
- Kërkesë për instalimin e rrjetit të internetit e datës 12.12.2016 lidhur me ndryshimin për pagesë të nëpunëses për pushimin e lehonisë;

- Konkurs i datës 11.09.2019 për pozitën "Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa";
- Konkurs i datës 13.09.2019 për pozitën "Asistent administrativ"
- Konkurs i datës 11.09.2019 për pozitën "Zyrtar i lartë për teknologji informative dhe logjistikë"
- Vendim me numër Ref:02/1006 i datës 26.09.2019 për emërimin e komisionit përzgjedhës për pozitën "Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa"
- Vendim me numër Ref:02/1039 i datës 26.09.2019 për emërimin e komisionit përzgjedhës për pozitën "Zyrtar i lartë për teknologji informative dhe logjistikë"
- Vendim me numër Ref:02/1056 i datës 01.10.2019 për emërimin e komisionit përzgjedhës për pozitën "Asistent administrativ" .
- Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale me numër Nr.Prot.02/09 i datës 11.01.2021.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit më datë 25.03.2021, ka konstatuar që ky institucion ka përgatitur Rregulloren në vitin 2013 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit por ende nuk është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe klasifikimi i vendeve të punës është përfunduar. Në këtë institucion janë të punësuar 12 nëpunës civil, ndërsa pozita të lira në këtë institucion kanë qenë 2.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë realizimit të vizitës monitoruese në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit ka shqyrtuar dosjet e nëpunësve civil për këto pozita "Ekspert për Sigurimin e Cilësisë", "Ekspert për Kualifikime" dhe "Ekspert për Standarde" dhe ka konstatuar këtë të gjetura :

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në dosjet e analizuara për pozitat „Ekspert për Sigurimin e Cilësisë“, „Ekspert për Kualifikime“ dhe „Ekspert për Standarde“ në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale ishin të kompletuara, mirëpo Kolegji i Këshillit gjatë monitorimit ka vërejtur se ruajtja e tyre nuk ishte në nivelin e duhur, gjegjësisht dosjet nuk ishin të vendosura dhe të ruajtura në sirtar të veçantë e të mbyllur me çelës ngase kemi të bëjmë me të dhënat personale e profesionale të nëpunësve të punësuar në këtë institucion, po ashtu dosjet e

nëpunësve civil kanë qenë të ruajtura vetëm mënyrë fizike e jo edhe elektronike, çka nënkupton se ky veprim i institucionit është në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2020 për Mirëmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Rekomandimi 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit dhe Udhëheqësin e Njesisë Burimeve Njerëzore që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, në mënyrë që të gjitha dosjet e nëpunësve civil të mbahen dhe ruhen ashtu siç përcaktohen me dispozitat e nenit 16 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 të Rregullores Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur një (1) pozitë me Ushtrues të Detyrës me vendim për pozitën "Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit".

E GJETURA 2: Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civil dhe sipas deklarimeve të zyrtarit të personelit, ka gjetur se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, gjatë vitit 2020 ka qenë vetëm një (1) pozite e lirë e cila është ushtruar me ushtrues të detyrës për pozitën "Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit" e cila është bërë me Vendimin me numër Nr.Prot.1910 të datës 21.08.2020.

Këshilli vlerëson së dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19 paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroje detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të

përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të behet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet ne pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla behet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Këshilli, duke marr parasysh se pozitat e punës kanë qenë të lira, konstaton se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të pozitave të lira me zëvendësues duke u thirrur në dispozitave të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur te zbatoje procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 2:

Rekomandojmë Ministren e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes së konstatuar në mënyrë që plotësim i pozitave të lira të behet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët, po ashtu rekomandojmë Drejtorin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në mënyrë që ne te ardhmen plotësimi i pozitave të lira të behet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit ka zhvilluar tri (3) procedura të rekrutimit/avancimi për pozitat: "Zyrtar i Lartë i IT-se dhe Logjistike", "Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa" dhe "Asistente administrative" dhe gjatë shqyrtimit të dosjeve për procedurën e rekrutimit nuk kemi konstatuar të gjetur.

Po ashtu në këtë institucion në vitin 2020 është shpallur konkursi për katër (4) pozita me marrëveshje për shërbime të veçanta si në vijim : “Ekspert të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional (IAAP)”, “Ekspert për trajnim të ofruesve që zbatojnë njohjen e mësimi paraprak (NJMP)”, “Ekspert për trajnim të ekipeve vlerësuese në procesin e akreditimit të institucioneve për zbatimin e NJMP-se” dhe “Ekspert për hartimin e rregullores së brendshme për aplikim në proceset e AKK-së”, për të cilat është zhvilluar procedurë e rekrutimit në pajtim me Ligjin Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare pasi që institucioni angazhon eksperte të fushave të ndryshme për një periudhë të shkurtër të kryerjes së detyrave.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandim

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit nuk e ka të themeluar Komisionin Disiplinor pasi që këto procedura në të kaluarën i ka zhvilluar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për arsye të numrit të vogël të nëpunësve civil në këtë institucion.

Në këtë fushë Kolegji për monitorim ka gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit nuk e ka të themeluar Komisionin Disiplinor.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duhet të nxjerr Vendim për themelimin e Komisionit Disiplinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 49 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me mandat 3 vjeçar. Në vendimin mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, duhet të përshkruhen pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të këtij komisionit. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 49 paragrafi 5 ka përcaktuar që Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Me nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: “Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: *Nëpunës civil i nivelit drejtues - Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional –anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar*”. Meqenëse kjo

dispozitë ka përcaktuar profesionin dhe nivelet e pozitive Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit Publike në aktin e themelimit të Komisionit Disiplinor duhet të përshkruaj edhe pozitën dhe profesionin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Rekomandimi 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Autoriteti Kombëtar të Kualifikimit Publike, që të ndër marr të gjitha veprimet procedurale për nxjerrjen e vendimit mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, dhe në vendim të shkruhet baza ligjore e emërimit të tij, të përshkruhen pozitën që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët, të përcaktohet mandati siç parashihet me dispozitat e nenit 49 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit nuk ka pasur të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me herët për shkak të numrit të vogël të nëpunësve civil në këtë institucion dhe se të gjitha ankesat që kanë arritur në këtë institucion e që kanë ardhur nga nëpunësit civil i ka shqyrtuar Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Gjatë vitit 2020 ka pasur 1 ankesë nga 1 nëpunës civil i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe pala ka parashtruar ankesë direkt në Këshill, mirëpo për të cilën Këshilli nuk ka vendosur në mungesë të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civil dhe nuk ka asnjë nëpunës të cilit nuk i është bërë vlerësimi i rezultateve në punë. Në vitin 2020 nuk ka pasur nëpunës civil ndaj të cilit është dashur të kryhet vlerësimi për periudhën provuese.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosjet personale respektivisht dosjes së nëpunëses për pozitën "Eksperte për sigurim të Cilësisë", ka konstatuar që formulari i vlerësimit të punës për vitin

2020 është nënshkruar nga vlerësuesi dhe e vlerësuar mirëpo i njëjti nuk përmban datën e vlerësimit nga vlerësuesi e as nga e vlerësuar që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Rekomandimi 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit, dhe Udhëheqësin e Personelit që t'i ndërmarr te gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të sigurohet se të gjithë nëpunësit civil janë vlerësuar nga menaxheret drejtues siç përcaktohet me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike.

Sipas evidencës për periudhën e monitorimit nuk ka pasur nëpunës civil të cilët kanë realizuar pushim mjekësor dhe pushim të lehonisë, ndërsa një (1) nëpunëse civile e ka realizuar pushimin pa pagesë e cila posedon dëshminë lidhur me raportin mjekësor për përkujdesje të prindit së bashku me kërkesën mbi pushimin pa pagesë dhe vendimin. Bazuar në të dhënat e dosjeve të shqyrtuara rezulton se pushimi pa pagesë është aprovuar paraprakisht me vendim, dhe mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Autoriteti Kombëtar të Kualifikimit gjatë vitit 2020 nuk ka pasur asnjë transferim të nëpunësve civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, ka të punësuar 10 nëpunës civil ku të gjithë të punësuarit janë të nacionalitetit shqiptar, ndërsa në këtë institucion nuk ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar se prej 10 nëpunësve civil të punësuar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, shtatë (7) të punësuar janë femra, ndërsa tre (3) janë meshkuj .

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit Institutin, gjatë vitit 2020 asnjë nëpunës nuk ka pezulluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil (pezullimit të dakorduar) respektivisht nëpunësi civil për pozitën "Ekspert për sigurimin e Cilësisë", me vendimin e datës 13.08.2018 është caktuar në pozitën si ushtrues detyre i "Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit", mirëpo që i njëjti në janar të vitit 2020 është kthyer në pozitën në të cilën ka qenë.

Në bazë të vlerësimit të dosjeve gjatë vitit 2020 një (1) nëpunëse civile ka realizuar pushim pa pagesë, e cila posedon dëshminë lidhur me raportin mjekësor për përkujdesje të prindit se bashku me kërkesën mbi pushimin pa pagesë dhe institucioni ka nxjerrë vendim për lejimin e pushimit pa pagesë, andaj Kolegji ka konstatuar se institucioni ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që nuk ka pasur nëpunës civil ndaj të cilëve është ndërprerë marrëdhënia e punës me shkarkim, që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (arritjes së moshës së pensionimit, ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësim me afat të caktuar, dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë) apo me vdekje.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë penale ndaj ndonjë nëpunësi civil, po ashtu nuk ka asnjë nëpunës civil që është dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka përgatitur Planin e Trajnimeve. Evidenca e trajnimeve mbahet në formë elektronike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, evidenca e vijimit në punë mbahet në formë fizike. Sipas deklarimit nga zyrtari i personelit dhe në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet. Po ashtu është konstatuar që në raste kur kane vëllim të madhe të punëve nëpunësit civil realizojnë shtesa jashtë orarit të punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit, gjatë vitit 2020 nuk ka pranuar asnjë vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky institucion është monitoruar në vitin 2017 ku janë dhënë gjashtë (6) rekomandime.

15. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit me rastin e mbikëqyrjes së të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit, ka arritur të konstatoj katër (4) të gjetura dhe ka dhënë katër (4) rekomandime lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresojnë dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojnë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin.

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- Ministres së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimit; dhe
- Arkiviot të KPMSHCK.